



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 3 nëntor 2020

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafi 1.4 dhe nenit 5 paragrafët 2, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit KPK/Nr. 537/2020 shpall:

KONKURS

Për emërimin e Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore në Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj

- I. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore në Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 1.1 Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 - 1.2 Të mos ketë të ngritur aktakuzë;
 - 1.3 Të mos jetë i dënuar për vepër penale;
 - 1.4 Të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tri vitet e fundit;
 - 1.5 Të mos ketë të shqiptuar sanksion disiplinor në pesë vitet e fundit, duke përjashtuar qortimin dhe vërejtjen jo publike;
 - 1.6 Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;
 - 1.7 Të plotësojë kriteret për emërim në Departamentin për të Mitur apo Departamentin për Krime të rënda të prokurorisë themelore.
- II. Kandidatët e interesuar për Kryeprokurorë të Prokurorive Themelore në Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj, duhet të plotësojnë formularin për aplikim, formularin për vetëvlerësim dhe formularin e koncept dokumentit të cilat janë të publikuara në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, autobiografinë (CV), dhe çfarëdo dokumenti tjetër relevant për të dokumentuar përvojën e tyre përfshirë rekomandimet.
- III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga komunitetet jo shumicë që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitat e Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore në Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj.
- IV. Konkursi do të jetë i hapur nga data **4 nëntor 2020 deri më 18 nëntor 2020**.
- V. Aplikacioni, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura, duhet të dorëzohen te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e pestë (5) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 505, të mbyllura në zarf, ose me postë.